



www.qbz.gov.al

Buletini i Njoftimeve Zyrtare I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2019 – Numri: 39

Tiranë – E hënë, 14 tetor 2019

PËRMBAJTJA

	Faqe
Njoftim i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 6284, datë 4.10.2019	Për shpalljen e dy vendeve vakante për pozicionin përkthyes..... 3
Njoftim i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 16850/1, datë 7.10.2019	Për marrjen pjesë në tryezat e diskutimit dhe të këshillimit, në kuadër të procesit të integritetit evropian..... 3
Njoftim i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 1253, datë 10.10.2019	Për shitje me ankand të pronës shtetërore, në administrim: të Ndërmarrjes së Seleksionimit të Metaleve Elbasan, të Ndërmarrjes së Prodhim-Çeliqueve Elbasan; të Bashkisë Belsh, të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë; të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, si dhe të shoqërive “Kamberi” sh.p.k. dhe “Vefa” sh.p.k..... 4
Kërkesë e Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit nr. 8522, datë 9.10.2019	Për botimin e vendimit për dënim administrativ, ndaj subjektit “Kleit Marvi”..... 9

**NJOFTIM****Nr. 6284, datë 4.10.2019****PËR SHPALLJEN E DY VENDEVE
VAKANTE PËR POZICIONIN
PËRKTHYES**

Në zbatim të nenit 20, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit shpall fillimin e procedurave, për personat e interesuar që kërkojnë të aplikojnë për pozicionin e përkthyesit, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, kategoria e pagës: II-b

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e mëposhtme:

a) të zotërojnë diplomë të arsimit të lartë, preferohet në gjuhë të huaja, dega Anglisht ose Drejtësi.

b) të kenë minimumi 2 vjet eksperiencë në përkthim shqip–anglisht–shqip.

c) të kenë njohuri shumë të mira në terminologjinë ligjore në të dyja gjuhët.

d) kanë përparësi kandidatët me eksperiencë pune pranë organizatave ndërkombëtare.

Kushte të përgjithshme:

- Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret për t’u pajisur me certifikatë sigurie, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 188, datë 4.3.2015.

- Ndaj tyre të mos ketë nisur procedim penal, të mos jenë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi ose kundërvajtjeje penale.

- Ndaj tyre të mos jetë marrë masë disiplinore me largim nga detyra ose ndonjë masë tjetër disiplinore, e cila është ende në fuqi sipas legjislacionit, në momentin e aplikimit.

- Kandidatët duhet të kenë aftësi për t’u përshtatur e për të punuar në grup, nën presion, si dhe në afate kohore të limituara.

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë dokumentet e mëposhtme:

1. Kërkesë me shkrim, shprehje interesi;

2. Jetëshkrim profesional, përfshirë të dhënat e kontaktit, postën elektronike zyrtare dhe adresën postare;

3. Kopje të dokumenteve (diplomë, letërnjoftim, librezë pune) (origjinale ose të noterizuara);

4. Dëshmi penaliteti;

5. Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;

6. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton plotësimin e kushteve të mësipërme, si dhe në trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim.

Aplikimet duhet të dorëzohen brenda 10 ditëve pas publikimit të njoftimit pranë institucionit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në adresën: Rruga e Kavajës, ish-Lidhja e Shkrimtarëve, Tiranë, zyra e protokollit, nga e hëna–të premte, ora 08:30–17:00 ose, nëpërmjet postës elektronike, në adresën: info@kpk.al, i cili konfirmon nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.

NJOFTIM**Nr. 16850/1, datë 7.10.2019****PËR MARRJEN PJESË NË TRYEZAT E
DISKUTIMIT DHE TË KËSHILLIMIT,
NË KUADËR TË PROCESIT TË
INTEGRIMIT EVROPIAN**

Në zbatim të urdhrit të Kryeministrit nr. 113, datë 30.8.2019, “Për format e pjesëmarrjes, funksionimin dhe strukturën institucionale të platformës së partneritetit për integrimin evropian”;

Ministria e Financave dhe Ekonomisë, në cilësinë e institucionit drejtues të kapitujve:

- kapitulli “Kriteri ekonomik”;

- kapitulli 1 “Lëvizja e lirë e mallrave”;

- kapitulli 2 “Lëvizja e lirë e punëtorëve”;

- kapitulli 3 “E drejta e vendosjes dhe liria për të ofruar shërbime”;

- kapitulli 6 “Legjislacioni për shoqëritë tregtare”;

- kapitulli 7 “E drejta e pronësisë intelektuale”;

- kapitulli 16 “Tatimet”;

- kapitulli 20 “Ndërmarrjet dhe politikat industriale”;

- kapitulli 28 “Mbrojtja e konsumatorit dhe shëndetit publik”;

- kapitulli 29 “Doganat”;

- kapitulli 30 “Marrëdhëniet me jashtë”;

- kapitulli 32 “Kontrolli financiar”;

- kapitulli 33 “Financat dhe buxheti”;

fton të marrin pjesë lirisht në tryezat e diskutimi dhe të këshillimit, në kuadër të procesit të integritetit evropian, të cilat krijohen në mënyrë



analoge me kapitujt e *acquis* të Bashkimit Evropian, përfaqësuesit e organizatave të shoqërisë civile, të pushtetit vendor, të komunitetit të biznesit, të shoqatave të punëmarrësve, të botës akademike, të medias dhe të grupeve të interesit, referuar përcaktimeve të kreut III.2, pika 4 të urdhrit.

Sipas përcaktimeve të kreut III.2, të urdhrit të Kryeministrit, aplikimi për t'u bërë pjesë e tryezave të diskutimit dhe të këshillimit kryhet nëpërmjet dorëzimit të një letre interesi, si dhe CV-së të personit apo të grupimit që përfaqëson, duke treguar se kanë ekspertizën apo interesin e mjaftueshëm për të kontribuar në tryezat specifike.

Personat apo përfaqësuesit e grupeve të interesit mund të paraqesin dokumentacionin e sipërcituar për pjesëmarrje, brenda datës 11 tetor 2019, në adresat e mëposhtme elektronike të sekretariateve teknike të GNP-së, sipas kapitujve më poshtë:

- kapitulli 1 “Lëvizja e lirë e mallrave”, kapitulli 3 “E drejta e vendosjes dhe liria për të ofruar shërbime” dhe kapitulli “Kriteri ekonomik”: Kevin.Treska@financa.gov.al

- kapitulli 6 “Legjislacioni për shoqëritë tregtare” dhe kapitulli 30 “Marrëdhëniet me jashtë”: Eva.Hamitaj@financa.gov.al

- kapitulli 7 “E drejta e pronësisë intelektuale”: Sonila.Meka@dppm.gov.al

- kapitulli 29 “Doganat” dhe kapitulli 32 “Kontrolli financiar”: Minushe.Malia@financa.gov.al

- kapitulli 2 “Lëvizja e lirë e punëtorëve”, kapitulli 28 “Mbrotja e konsumatorit dhe shëndetit publik” dhe kapitulli 33 “Financat dhe buxheti”: Jetnor.Kasmi@financa.gov.al

- kapitulli 16 “Tatimet” dhe kapitulli 20 “Ndërmarrjet dhe politikat industriale”: Ilda.Pashaj@financa.gov.al

Përzgjedhja e personave apo e përfaqësuesve të grupeve të interesit do të bëhet sipas urdhrit të Kryeministrit nr. 113, datë 30.8.2019.

NJOFTIM

Nr. 1253, datë 10.10.2019

PËR SHITJE ME ANKAND TË PRONËS SHTETËRORE, NË ADMINISTRIM TË NDËRMARRJES SË SELEKSIONIMIT TË METALEVE ELBASAN DHE NDËRMARRJES SË PRODHIM- ÇELIQEVE ELBASAN

Në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 926, datë 29.12.2014, “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet apo transformohet dhe procedurën e shitjes”, kapitulli III, shpall për shitje me VAM fillestar, si më poshtë:

1. Në administrim të Ndërmarrjes së Seleksionimit të Metaleve Elbasan

Nr.	Emërtimi i objektit	Vendndodhja	Vlerat (në lekë)			Sipërfaqja e përgjithshme (m ²)	Sipërfaqja nën objekt (m ²)	Zhvillimi i ankandit		
			Vlera fillestare e ankandit (mjete kryesore + truall)	Mjetet kryesore	Truall			Data	Ora	Vendi
1	Zyra e repartit të lëndëve të para të furnaltave	Elbasan	699 319	644 095	55 224	236	36	6.11.2019	09:00	DDPP

2. Në administrim të Ndërmarrjes së Prodhim-Çeliqueve Elbasan

Nr.	Emërtimi i objektit	Vendndodhja	Vlerat (në lekë)			Sipërfaqja e përgjithshme (m ²)	Sipërfaqja nën objekt (m ²)	Zhvillimi i ankandit		
			Vlera fillestare e ankandit (mjete kryesore + truall)	Mjetet kryesore	Truall			Data	Ora	Vendi
1	Reparti i prodhimeve të imëta	Elbasan	3 032 104	2 633 532	398 572	1703.3	246.9	6.11.2018	10:00	DDPP



Çdo person fizik apo juridik, i interesuar për blerje me ankand, duhet të paraqesë në vendin, datën dhe orën e njoftuar pranë komisionit të ankandit, dokumentacionin si më poshtë:

1. **Kërkesë me shkrim** për blerjen e objektit apo të ndërmarrjes, e regjistruar pranë protokollit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

2. **Mandatpagesën apo garancinë bankare,** në original, që vërteton derdhjen apo ngurtësimin e 20% të vlerës së fillimit të ankandit, në lekë, për llogari të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

3. **Dokument identifikimi** (pasaportë biometrike ose letërnjoftim).

Shënim. Pjesëmarrësi në ankand, i cili tërhiqet nga ankandi pa dhënë asnjë ofertë për vlerën e objektit të shpallur për shitje, nuk i kthehet 20% e vlerës fillestare të ngurtësuar për pjesëmarrje në ankand.

Subjekti i shpronësuar i truallit, mbi të cilin ndodhet objekti apo ndërmarrja, duhet të paraqesë në vendin, datën dhe orën e njoftuar pranë komisionit të ankandit, dokumentacionin si më poshtë:

1. **Kërkesë me shkrim** për blerjen e objektit apo të ndërmarrjes, e regjistruar pranë protokollit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

2. **Mandatpagesën apo garancinë bankare** që vërteton ngurtësimin e 20 për qind të vlerës fillestare në lekë, vetëm për objektin (mjete kryesore), për llogari të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, në Drejtorinë e Drejtimit të Pronës Publike, detyrimisht brenda afatit të pranimi të kërkesave.

3. **Vendimin e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave,** të shoqëruar me planvendosjen e pronës, ku përcaktohet se ai është subjekt pronar i tokës.

4. **Dëshminë e trashëgimisë,** prokurë përfaqësimi etj., nëse ka të tilla.

5. **Deklaratë noteriale,** në të cilën trashëgimtarët e subjektit të shpronësuar, që

kërkojnë të ushtrojnë të drejtën e parablerjes për objektin në proces privatizimi, të deklarojnë, se, që nga momenti që janë pajisur me vendimin e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, nuk kanë përfutur kompensim në asnjë nga format e parashikuara në ligj. Gjithashtu, të deklarojnë se vendimi i ish-Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ose i Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave nuk ka ndryshuar ose është shfuqizuar me ndonjë akt administrativ apo vendim të formës së prerë.

Mandatpagesa apo garancia bankare duhet të bëhet detyrimisht brenda afatit të pranimi të kërkesave për pjesëmarrje në ankand. Mandatpagesa apo garancia bankare mund të bëhen pranë çdo banke të nivelit të dytë, në llogaritë respektive të hapura për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, pasi të keni tërhequr pranë DDPP-së ose degëve të thesarit në rrethe faturën për arkëtim, të plotësuar dhe të nënshkruar nga përfaqësuesi i institucionit.

Këto informacione gjenden edhe në faqen e internetit të Ministrisë së Financave: www.financa.gov.al

NJOFTIM

Nr. 1253, datë 10.10.2019

PËR SHITJE ME ANKAND TË PRONËS SHTETËRORE, NË ADMINISTRIM TË BASHKISË BELSH DHE MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË

Në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 926, datë 29.12.2014, “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet apo transformohet dhe procedurën e shitjes”, të ndryshuar, kapitulli III, shpall për shitje me VAM të ulur, si më poshtë:

1. Në administrim të Bashkisë Belsh

Nr.	Emërtimi i objektit	Vendndodhja	Vlerat (në lekë)			Sipërfaqja e përgjithshme (m ²)	Sipërfaqja nën objekt (m ²)	Zhvillimi i ankandit		
			Vlera fillestare e ankandit (mjete kryesore + truall)	Mjetet kryesore	Trualli			Data	Ora	Vendi
1	Ish-zyrat e Drejtorisë së Ujërave, Belsh	Belsh	2 172 383	2 153 034	19 349.46	82.69	82.69	6.11.2019	11:00	DDPP



Shënim. Për këtë objekt është lidhur kontratë qiraje nr. 2619 prot., datë 19.7.2019, midis Bashkisë Belsh dhe subjektit z. Artur Kurti, për periudhën 12-mujore, nga data 19.7.2019 deri në datën 19.7.2020.

2. Në administrim të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë

Nr.	Emërtimi i objektit	Vendndodhja	Vlerat (në lekë)			Sipërfaqja e përgjithshme (m ²)	Sipërfaqja nën objekt (m ²)	Zhvillimi i ankandit		
			Vlera fillestare e ankandit (mjete kryesore + truall)	Mjetet kryesore	Truall			Data	Ora	Vendi
1	Magazinë e ish-grumbullimit	Matranxh, Kukës	794 205.6	747 278	46 927.6	231.168	231.168	6.11.2019	12:00	DDPP

Çdo person fizik apo juridik, i interesuar për blerje me ankand, duhet të paraqesë në vendin, datën dhe orën e njoftuar pranë komisionit të ankandit, dokumentacionin si më poshtë:

1. **Kërkesë me shkrim** për blerjen e objektit apo të ndërmarrjes, e regjistruar pranë protokollit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

2. **Mandatpagesën apo garancinë bankare,** në origjinal, që vërteton derdhjen apo ngurtësimin e 20% të vlerës së fillimit të ankandit, në lekë për llogari të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

3. **Dokument identifikimi** (pasaportë biometrike ose letërnjoftim).

Shënim. Pjesëmarrësi në ankand, i cili tërhiqet nga ankandi pa dhënë asnjë ofertë për vlerën e objektit të shpallur për shitje, nuk i kthehet 20% e vlerës fillestare, të ngurtësuar për pjesëmarrje në ankand.

Subjekti i shpronësuar i truallit, mbi të cilin ndodhet objekti apo ndërmarrja, duhet të paraqesë në vendin, datën dhe orën e njoftuar pranë komisionit të ankandit dokumentacionin, si më poshtë:

1. **Kërkesë me shkrim** për blerjen e objektit apo të ndërmarrjes, e regjistruar pranë protokollit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

2. **Mandatpagesën apo garancinë bankare** që vërteton ngurtësimin e 20 për qind të vlerës fillestare në lekë, vetëm për objektin (mjete kryesore), për llogari të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, në Drejtorinë e Drejtimit të Pronës Publike, detyrimisht brenda afatit të pranimit të kërkesave.

3. **Vendimin e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave,** të shoqëruar me

planvendosjen e pronës, ku përcaktohet se ai është subjekt pronar i tokës.

4. **Dëshminë e trashëgimisë,** prokurë përfaqësimi etj., nëse ka të tilla.

5. **Deklaratë noteriale,** në të cilën trashëgimtarët e subjektit të shpronësuar që kërkojnë të ushtrojnë të drejtën e parablerjes për objektin në proces privatizimi, të deklarojnë, se, që nga momenti që janë pajisur me vendimin e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, nuk kanë përfituar kompensim në asnjë nga format e parashikuara në ligj. Gjithashtu, të deklarojnë, se vendimi i ish-Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ose i Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave nuk ka ndryshuar ose është shfuqizuar me ndonjë akt administrativ apo vendim të formës së prerë.

Mandatpagesa apo garancia bankare duhet të bëhet detyrimisht brenda afatit të pranimit të kërkesave për pjesëmarrje në ankand. Mandatpagesa apo garancia bankare mund të bëhen pranë çdo banke të nivelit të dytë, në llogaritë respektive të hapura për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, pasi të keni tërhequr pranë DDPP-së ose degëve të thesarit në rrethe faturën për arkëtim, të plotësuar dhe të nënshkruar nga përfaqësuesi i institucionit.

Këto informacione gjenden edhe në faqen e internetit të Ministrisë së Financave: www.financa.gov.al



NJOFTIM
Nr. 1253, datë 10.10.2019

**PËR SHITJE ME ANKAND TË PRONËS
SHTETËRORE, NË ADMINISTRIM TË
MINISTRISË SË ENERGJISË DHE
INDUSTRIË**

Në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 926, datë 29.12.2014, “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet apo transformohet dhe procedurën e shitjes”, të ndryshuar, shpall për shitje si më poshtë:

1. Në administrim të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë

Nr.	Emërtimi i objektit	Vendndodhja	Vlerat (në lekë)			Sipërfaqja e përgjithshme (m ²)	Sipërfaqja nën objekt (m ²)	Zhvillimi i ankandit		
			Vlera fillestare e ankandit	Mjetet kryesore	Trualli			Data	Ora	Vendi
1	Objektet nr. 21/1, 21/2, 21/3 dhe pjesa e mbetur e objektit 21”, të ish-ndërmarrjes “Goma”, Durrës	Durrës	5 372 817	2 121 537	3 251 280	276	276	6.11.2019	13:00	DDPP

Çdo person fizik apo juridik, i interesuar për blerje me ankand, duhet të paraqesë në vendin, datën dhe orën e njoftuar pranë komisionit të ankandit, dokumentacionin si më poshtë:

1. Kërkesë me shkrim për blerjen e objektit apo të ndërmarrjes, e regjistruar pranë protokollit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

2. Mandatpagesën apo garancinë bankare në origjinal që vërteton derdhjen apo ngurtësimin e 20% të vlerës së fillimit të ankandit, në lekë për llogari të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

3. Dokument identifikimi (pasaportë biometrike ose letërnjoftim).

Shënim. Pjesëmarrësi në ankand, i cili tërhiqet nga ankandi pa dhënë asnjë ofertë për vlerën e objektit të shpallur për shitje, nuk i kthehet 20% e vlerës fillestare, të ngurtësuar për pjesëmarrje në ankand.

Subjekti i shpronësuar i truallit, mbi të cilin ndodhet objekti apo ndërmarrja, duhet të paraqesë në vendin, datën dhe orën e njoftuar pranë komisionit të ankandit dokumentacionin, si më poshtë:

1. Kërkesë me shkrim për blerjen e objektit apo të ndërmarrjes, e regjistruar pranë protokollit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

2. Mandatpagesën apo garancinë bankare, që vërteton ngurtësimin e 20 për qind të vlerës fillestare në lekë, vetëm për objektin (mjete kryesore), për llogari të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, në Drejtorinë e Drejtimit të Pronës Publike, detyrimisht brenda afatit të pranimit të kërkesave.

3. Vendimin e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, të shoqëruar me planvendosjen e pronës, ku përcaktohet se ai është subjekt pronar i tokës.

4. Dëshminë e trashëgimisë, prokurë përfaqësimi etj., nëse ka të tilla.

5. Deklaratë noteriale, në të cilën trashëgimtarët e subjektit të shpronësuar, që kërkojnë të ushtrojnë të drejtën e parablerjes për objektin në proces privatizimi, të deklarojnë, se, që nga momenti që janë pajisur me vendimin e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, nuk kanë përfituar kompensim në asnjë nga format e parashikuara në ligj. Gjithashtu, të deklarojnë se vendimi i ish-Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ose i Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të



Pronave, nuk ka ndryshuar ose është shfuqizuar me ndonjë akt administrativ apo vendim të formës së prerë.

Mandatpagesa apo garancia bankare duhet të bëhet detyrimsht brenda afatit të pranimi të kërkesave për pjesëmarrje në ankand. Mandatpagesa apo garancia bankare mund të bëhen pranë çdo banke të nivelit të dytë në llogaritë respektive të hapura për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, pasi të keni tërhequr pranë DDPP-së ose degëve të thesarit në rrethe faturën për arkëtim të plotësuar dhe të nënshkruar nga përfaqësuesi i institucionit.

Këto informacione gjenden edhe në faqen e internetit të Ministrisë së Financave: www.financa.gov.al

NJOFTIM
Nr. 1253, datë 10.10.2019

**PËR SHITJE ME ANKAND TË
PRONËS SHTETËRORE, NË
ADMINISTRIM TË SHOQËRISË
“KAMBERI” SHPK DHE TË SHOQËRISË
“VEFA” SHPK**

Në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 926, datë 29.12.2014, “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet apo transformohet dhe procedurën e shitjes”, kapitulli III, shpall për shitje, si më poshtë:

1. Në pronësi të shoqërisë “Kamberi” sh.p.k.

Nr.	Emërtimi i objektit	Vendndodhja	Vlerat (në lekë)			Sipërfaqja e përgjithshme (m ²)	Sipërfaqja nën objekt (m ²)	Zhvillimi i Ankandit		
			Vlera fillestare e ankandit	Mjetet kryesore	Trualli			Data	Ora	Vendi
1	Njësi tregtimi, me sip. 42 m ²	Vlorë	4 200 000			42		7.11.2019	10:00	DDPP

2. Në pronësi të shoqërisë “Vefa” sh.p.k.

Nr.	Emërtimi i objektit	Vendndodhja	Vlerat (në lekë)			Sipërfaqja e përgjithshme (m ²)	Sipërfaqja nën objekt (m ²)	Zhvillimi i ankandit		
			Vlera fillestare e ankandit	Mjetet kryesore	Trualli			Data	Ora	Vendi
1	Truall me sip. 500 m ²	Vlorë	5 500 000			500		7.11.2019	10:30	DDPP

3. Në pronësi të shoqërisë “Vefa” sh.p.k.

Nr.	Emërtimi i objektit	Vendndodhja	Vlerat (në lekë)			Sipërfaqja e përgjithshme (m ²)	Sipërfaqja nën objekt (m ²)	Zhvillimi i ankandit		
			Vlera fillestare e ankandit	Mjetet kryesore	Trualli			Data	Ora	Vendi
1	Truall me sip. 2065 m ² Ndërtesë me sip 116.5 m ²	Paskuqan	9 000 000			2065		7.11.2019	11:00	DDPP

4. Në pronësi të shoqërisë “Vefa” sh.p.k.

Nr.	Emërtimi i objektit	Vendndodhja	Vlerat (në lekë)			Sipërfaqja e përgjithshme (m ²)	Sipërfaqja nën objekt (m ²)	Zhvillimi i ankandit		
			Vlera fillestare e ankandit	Mjetet kryesore	Trualli			Data	Ora	Vendi
1	Arë + truall	Berat	3 300 000			1 465		7.11.2019	11:30	DDPP



Çdo person fizik apo juridik, i interesuar për blerje me ankand, duhet të paraqesë në vendin, datën dhe orën e njoftuar pranë komisionit të ankandit, dokumentacionin si më poshtë:

1. **Kërkesë me shkrim** për blerjen e objektit apo të ndërmarrjes, e regjistruar pranë protokollit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

2. **Mandatpagesën apo garancinë bankare**, në origjinal, që vërteton derdhjen apo ngurtësimin e 20% të vlerës së fillimit të ankandit, në lekë për llogari të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

3. **Dokument identifikimi** (pasaportë biometrike ose letërnjoftim).

Shënim. Pjesëmarrësi në ankand, i cili tërhiqet nga ankandi pa dhënë asnjë ofertë për vlerën e objektit të shpallur për shitje, nuk i kthehet 20% e vlerës fillestare, të ngurtësuar për pjesëmarrje në ankand.

KËRKESË

Nr. 8522, datë 9.10.2019

PËR BOTIMIN E VENDIMIT PËR DËNIM ADMINISTRATIV, NDAJ SUBJEKTIT “KLEIT MARVI”

Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit Qendër, megjithëse ka realizuar njoftimin zyrtar për procedurën e inspektimit, nëpërmjet shërbimit postar është kthyer njoftimi i institucionit tonë, duke u konfirmuar nga shërbimi postar, largimi i subjektit nga ajo adresë apo adresë jo e saktë.

Sa më sipër, Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit Qendër, bën njoftimin publik të procedurës së inspektimit, respektivisht për subjektin si më poshtë:

- **Kleit Marvi**

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM I MTM-së
KRYEINSPEKTOR I KOMANDUAR
Adrian Kamenica



Kopje e vërtetuar me origjinalin


REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT
INSPEKTORATI SHTETËROR I MJEDISIT, PYJEVE, UJËRAVE DHE TURIZMIT
DREJTORIA QENDRORE
AUTORIZIM INSPEKTIMI

Data 08.02.2019

Nr. ISHMPUT-DQ-2019-000053 - 1 Data: 06/02/2019

Bazuar në Nenin 27 të Ligjit Nr.10433, datë 16.06.2011 "Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë, VKM Nr. 338 datë 06.06.2018 të Këshillit të Ministrave Për Disa Ndryshime dhe Shtesa në Vendimin nr. 103 datë 04.02.2015, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin dhe Mënyrën e Organizimit e të Funkcionimit të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve" të Ndryshuar, si dhe të Ligjit 93/2015 "Për Turizmin", autorizoj inspektimin e

Të dhëna mbi subjektin e inspektimit:

Emri i subjektit: KLEIT MARVI NIPT: 1868210068
 Adresa/vendndodhja: Lagjia Kongresi i Permetit, Rruga Isuf Sokoli, nr pasurie 3/1033, zona kadastrale 8591, Shkoder, SHKODER, Shkoder

Përshkrim i objektit të inspektimit:

Inspektim jashtë programit konsiderohet edhe inspektimi në kushtet e flagrancës.

Inspektorët e autorizuar për të kryer inspektimin:

Zenel Muka ID: 0701010001
Eltan Casili ID: 0700010002

Kohëzgjatja e inspektimit: Një ditë
06/02/2019 10:00 06/02/2019 16:00
 (ora, data e fillimit) (ora, data e përfundimit)

Vendi/vendet ku do të kryehet inspektimi (adresa/t): Rruga Nacionale Milot-Lezhe, nr pasurie 30/138, zona kadastrale 1677, Milot, LAC, Lezhe

Njoftimi paraprak i autorizimit subjektit të inspektimit: Po ☐ Jo ☒

Njoftimi paraprak i autorizimit nuk njoftohet për arsye: Për të mos cenuar efektivitetin e inspektimit, siç parashikohet në pikën 2, të nenit 32 të ligjit nr. 10 433, datë 16.06. 2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë"

KRYEINSPEKTORI



Subjekti: _____ Subjekti Mbyllur:



tëpër shprehur
me shprehje, shprehje

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT
INSPEKTORATI SHTETËROR I MJEDISIT, PYJEVE, UJËRAVE DHE TURIZMIT
DREJTORIA QENDRORE
PROCESVERBAL INSPEKTIMI

JH 1305/2 Prot

Data 08.02.2019

Nr. ISHMPUT-DQ-2019-000053 - 2 Datë: 08/02/2019

Bazuar në Nenin 45 të Ligjit Nr.10433, datë 16.06.2011 "Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë,

I. TË DHËNA TË PËRGJITHSHME:

Emri i subjektit: KLEIT MARVI NIPT: L868210068
 Adresa/vendndodhja: Adresa Kryesore: Lagjia Kongresi i Permetit, Rruga Isuf Sokoli, nr pasurie 3/1033, zona kadastrale 8591, Shkoder, SHKODER, Shkoder, Dega: Rruga Nacionale Milot-Lexhe, nr pasurie 30/138, zona kadastrale 1677, Milot IAC, Lexhe
 Emri i Punëdhënësit: Kirzen Bushati

Kohëzgjatja e inspektimit në vendin e inspektimit: 5 (orë)

05/02/2019 10:00 06/02/2019 16:00
 (ora, data e fillimit) (ora, data e përfundimit)

→ Vendi/vendet e inspektimit (adresa/t): Rruga Nacionale Milot-Lexhe, nr pasurie 30/138, zona kadastrale 1677, Milot IAC, Lexhe

Njoftim paraprak lënë subjektit: Po ☐ Jo ☒

Rubrikë e posaçme: inspektim me autorizim: Po ☒ Jo ☐

Lloji i autorizimit: autorizim i afishuar: Po ☐ Jo ☒

Hyrja dhe inspektimi forcërisht në prani të punonjësit të Policisë së Shtetit: Po ☐ Jo ☒

Përfundimi i përfaqësuesit të subjektit të inspektimit: Po ☐ Jo ☒

Arsyetimi i përfundimit: Nuk ka

Masa urgjente: Po ☐ Jo ☒

II. PROCEDURA E INSPEKTIMIT

1. Mostra të marra: Po ☐ Jo ☒

Nuk ka



logje e upletuar me origjinalin

2. Dokumente të marra:

Nuk ka

3. Vendim për sekuestrim dokumentacioni:

Nuk ka

4. Detyra të pajezuara nga inspektimi i mëparshëm:

5. Detyrimi i subjektit për paraqitje në zyrën e Inspektorit: Po ☐ Jo ☒

6. Dokumentacioni dhe sendet që duhet të paraqesni:

Dokumente të paraqitura:

Nr.	Dokumenti dhe Përshkrimi
1.	

Sendet të paraqitura:

Nr.	Sendet dhe Përshkrimi
1.	

Mosparaqitja do të konsiderohet pengim në kryesjen e detyrës së Inspektorit Shtetëror referuar nenit 54, të ligjit 10433, datë 16.06.2011, "Për inspektimin në RSH".

7. Gjetjet e konstatuara

Ka shkelje të kërkesave ligjore: Po ☒ Jo ☐

Gjetjet e konstatuara në këtë procesverbal bien në kundërshtim me kërkesat ligjore të parashikuara në nenin/et e ligjit/ve:

1. Neni: 44, Ligji Nr. 111/2012 "PËR MENAXHIMIN E INTEGRUAR TË BURIMEVE UJORE". Pika: 1. Komente: Subjekti ben ndërtim e materialeve inerte me leje për shfrytëzimin e inerteve lumore në Lumin Mat me vendim nr.3, datë 22.11.2018. Subjekti është në kundërshtim me Vendimin nr. 1, datë 21.06.2006 të VKKU. Nga konstatimi i bërë në terren rezultoi se subjekti nuk zbaton afatin e këtij vendimi.

8. Njoftimi i procesverbalit të subjektit të inspektimit

Për faktet dhe rrethanat e konstatuara të paraqitura në këtë procesverbal, subjekti mund të paraqesë shpjegimet apo kontestimet e tij me shkrim ose me gojë pranë Inspektoratit Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave, brenda datës së përcaktuar nga ligji.

Me përfundimin e këtij afati, do të merret vendimi përfundimtar i inspektimit.

Bashkëlidhur listë verifikimi i plotësuar gjatë inspektimit.

9. Në rast se nuk konstatohen shkelje të jepen arsyet e përfundimit të procedimit.



Kopje e vlerësuar me origjinalin

III. KUNDRAVAJTJET ADMINISTRATIVE

Për shkak të shkeljeve të konstatuara të kërkesave ligjore të subjektit të inspektimit, në mbështetje të ligjit ligji 117/2012 "PËR MENAXHIMIN E INTEGRUAR TË BUDIMETVE UJORE", datë 11/15/2012, nenit/meneve 97, pikë 5., ato klasifikohen si kundërvajtje administrative dhe parashikohen dënimet administrative si më poshtë:

1. Dënim administrativ kryesor:

Gjohë : 2000000 Lekë.

2. Dënim administrativ plotësues:

Pezullim të aktivitetit në zbatim të afateve e përcaktuara në Vendimin e KXU Nr. 1, datë 21.06.2006.

Shkeljet e kërkesave ligjore për t'u korrigjuar:

•

Bashkëlidhur fletë shoqëruese për këshillimin me shkrim të subjektit për mënyrën e korrigjimit të shkeljeve.

•

Bashkëlidhur dokumente që inspektori i gjykon të nevojshme për procesin e inspektimit.

IV. VENDIMI PËRFUNDIMTAR

Vendim përfundimtar i veçantë:

Këshillimet

Nuk ka

V. FORMALIZIMI

Ky procesverbal u mbajt sot më datën 08/02/2019 dhe pasi lexohet nënshkruhet si më poshtë:

Inspektori/ët të mjedisit, pyjeve dhe ujërave
Zenel Muka ID: 0701010001
Elton Casili ID: 0700010002

Personi i autorizuar nga subjekti
Tonin Papa (Refuzon Firmën)

Bashkëlidhur listë-verifikimi i plotësuar gjatë inspektimit.

Kopje e vlerësuar me origjinalin

Procesverbal i kërkuar subjektit brenda 5 ditëve nga data e përfundimit të inspektimit
 Ky procesverbal mbahet në 3 kopje dhe nënshkruhet nga inspektori dhe mbahet një



Kopje e ngritur me origjinalin.




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT
INSPEKTORATI SHTETËROR I MJEDISIT, PYJEVE, UJËRAVE DHE TURIZMIT
DREJTORIA QENDRORE
VENDIMI PËRFUNDIMTAR I INSPEKTIMIT

Nr. 1305/3 Prot Data 08.02.2019

Nr. ISHMPUT-DQ-2019-000053 - 5 Datë: 08/02/2019

Bazuar në nenin 46 të Ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë" dhe procesverbalin e inspektimit Nr. ISHMPUT-DQ-2019-000053 - 2, datë 08/02/2019, inspektim, që është zhvilluar në subjektin KLEIT MARVI, NIPT 1868210068, Punëdhënës Tonin Pepa (Refuzon Firmen), prej datës 06/02/2019 10:00 deri më datën 06/02/2019 16:00.

Grupi i punës, pasi realizoi inspektimin, e hartoi procesverbalin e inspektimit në datë 08/02/2019 dhe e njoftoi në datë 08/02/2019. Në bazë të procesverbalit të inspektimit dhe kontestimeve të subjektit të inspektimit rezultuan këto shkelje të kërkesave ligjore: Nr. 111/2012 "PËR MENAXHIMIN E INTEGRUAR TË BURIMEVE UJORE" 44.1.

Për shkak të shkeljeve të konstatuara të kërkesave ligjore të subjektit të inspektimit, në mbështetje të ligjit Nuk ka, ato klasifikohen si kundërvajtje administrative dhe parashikohen dënimet administrative si më poshtë:

- Dënim administrativ kryesor:
Gjohë 2000000 Lekë
- Dënim administrativ plotësues:
Pezullim të aktivitetit në zbatim të afateve e nercaktuara në Vendimin e KRU Nr.1, datë 21.06.2006

Korrigjimi i shkeljeve të konstatuara dhe eliminimi i pasojave të tyre në një afat kohor të arsyeshëm. Detyra për t'u realizuar me afate kohore respektive:

Inspektorët Shtetëror të autorizuar:

Zenel Muka ID: 0701010001
Elton Casili ID: 0700010002

Kundër Vendimit Përfundimtar, subjekti KLEIT MARVI ka të drejtën e ankimit brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të vendimit përfundimtar. Ankimi paraqitet pranë "Organit Epror", Komisionit të Ankimit të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave. Vendimi përfundimtar mbahet në 4 kopje.

Buletini i Njoftimeve Zyrtare shpërndahet falas në çdo pikë të Postës Shqiptare.
Përmbajtja e Buletinit Zyrtar mund të konsultohet falas dhe pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare.

Tiranë, 2019